



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "NTSH Infratek" të datës 02.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 29.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Konkurs projektimi për hartimin e projektit kryesor të nënkalimit në pikëtakimin e rrugës magjistrale M2 me rrugën A - lagjen Kalabria" me nr. të prokurimit 616-22- 14679-4-1-3 dhe nr. të brendshëm 616 22 215 413, Komuna e Prishtinës (AK) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "NTSH Infratek" e datës 01.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 29.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Konkurs projektimi për hartimin e projektit kryesor të nënkalimit në pikëtakimin e rrugës magjistrale M2 me rrugën A - lagjen Kalabria" me nr. të prokurimit 616-22- 14679-4-1-3 dhe nr. të brendshëm 616 22 215 413.
- II. **VËRTETOHET** njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i dt. 29.05.2023.
- III. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- IV. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "NTSH Infratek" si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "NTSH Infratek" (tutje "parashtruesi") me datë 01.06.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 29.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Konkurs projektimi për hartimin e projektit kryesor të nënkalimit në pikëtakimin e rrugës magjistrale M2 me rrugën A - lagjen Kalabria" me nr. të prokurimit 616-22- 14679-4-1-3 dhe nr. të brendshëm 616 22 215 413.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se parashtruesi është eliminuar nga ky konkurs i projektimit për shkak se në fazën e parë parashtruesi nuk dorëzuar dokumentacionin në përputhje me nenin 55 par. 55.16 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP"). Bazuar në nenin 59 par. 59.1 të RRPP është përcaktuar se "kërkesa për rishqyrtim mund të dorëzohet, pa pagese, nga cilado palë e interesuar". Sa i përket nocionit "palë e interesuar" sipas nenit 4 par. 1 nën par. 26 të LPP është përcaktuar se "Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar".

Lidhur me kërkesën për rishqyrtim të parashtruesit fillimisht duhet cekur se ky aktivitet i prokurimit zhvillohet si procedurë mbi konkursin për projektim përmes dorëzimit fizik (me dy zarfe). Tutje përmes nenit 55 paragrafit 55.16 RRPP është përcaktuar se "Të dy zarfet, që përmbajnë "Projektimin Ideor" dhe "Dokumentacionin e Kandidatit", pastaj do të mbyllën në një zarf të jashtëm të shënuar me: a. Adresën e vendit për dorëzim të konkurseve për projektim; b. Numrin e Prokurimit; dhe c. Një numër anonim prej katër shifrave sipas zgjedhjes së pjesëmarrësit". Sipas kësaj dispozite të RRPP rezulton që ofertuesit me rastin e dorëzimit të dokumentacionit nuk duhet të evidentojnë asnjë shenjë tjetër identifikuese përveç një numri katër (4) shifror sikurse përcakohet me nenin 55 par. 55.16 të RRPP. Nga procesverbali i hapjes së tenderëve në këtë rast është gjetur se parashtruesi nuk ka evidentuar një numër katër (4) shifror sipas nenit 55 par. 55.16 të RRPP mirëpo në vend të kësaj ka evidentuar shenjën si në vijim "810545907 (2510)". Në këtë mënyrë parashtruesi ka vepruar në kundërshtim me nenin 55 par. 55.16 të RRPP dhe për pasojë është eliminuar nga gara. Sa i përket pjesës së pretendimit ku thuhet se parashtruesi e ka evidentuar këtë shenjë për shkak se është udhëzuar nga person i caktuar, duhet potencuar se parashtruesi as që ka tentuar që të vërtetoj këtë pjesë të pretendimit të tij. Me fjalë të tjera nuk ka dorëzuar asnjë provë apo dëshmi me të cilën do të mund të konfirmohet një pretendim i tillë. Prandaj autoriteti kontraktues në mungesë të argumenteve dhe provave nuk ka se si t'i falë besimin një pretendimi të tillë. Rrjedhimisht ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar në tërësi.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk është fare palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP lidhur me nenin 59 të RRPP. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit si e tillë është e pavlefshme. Në anën tjetër parashtruesi në kërkesën për rishqyrtim nuk ka paraqitur dëshmi apo

argumente të qëndrueshme për të vërtetuar se është palë e interesit. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I, II dhe III të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën IV dhe V të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 09.06.2023



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.